

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .02.2022

**ALBPETROL SHA PATOS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Data 21.02.2022

Nga: "Albpetrol "sha - Patos

Drejtuar: "VIBTIS" shpk

Adresa: Tiranë, Rruga "Dervish Hima", Arena Center, Seksioni B/C, Kati 5.

NUIS L02103503S

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-16770-12-30-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje kalimatësa nafte (flow-meter)".

Kohezgjatja e kontrates është 120 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 192 datë 31 Dhetor.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë Procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "NOVAMAT" shpk me NUIS K81615002O, me vlerë oferte në total 32,400,000 leke (pa TVSH).
2. Operatori ekonomik "VIBTIS" shpk me NUIS L02103503S, me vlerë oferte ne total 37,178,181 leke (pa TVSH).
3. Operatori ekonomik "LLAZO" shpk me NUIS K24218401K, me vlerë oferte ne total 37,367,866.2 leke (pa TVSH).
4. Operatori ekonomik "FMAC" shpk me NUIS M02303026K, me vlerë oferte ne total 37,520,000 leke (pa TVSH).
5. Operatori ekonomik "START CO" shpk me NUIS L11614001S, me vlerë oferte ne total 37,886,188 leke (pa TVSH).

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik "NOVAMAT" shpk me NUIS K81615002O për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik konsiderohet se nuk ka plotësuar kriterin 2.3.1. të kapacitetit teknik të kërkesave për kualifikim lidhur me furnizimet e mëparshme të ngjashme.
- Konkretisht Operatori ekonomik ka paraqitur furnizime të mëparshme si "Blerje pajisje dhe pjesë rezervë për mirëmbajtjen e agregateve e pajisjeve të centralit" të cilat nuk janë të ngjashme dhe në përputhje me fushën e qëllimit të përdorimit dhe specifikat e F.V së mallrave objekt prokurimi sipas kriterit të kërkuar nga AK. Ndërsa, furnizimi i realizuar me ProGroup sh.p.k konsiderohet si furnizim i ngjashëm por vlera e tij është nën vlerën e 40 % të Fondit limit sipas kriterit të kërkuar nga AK.
- Sipas katalogut të paraqitur nuk specifikohen densiteti dhe viskoziteti i fluidit (nafte bruto) sipas kërkesave në specifikimet teknike të DST-ve, për të cilat duhet të pershtaten dhe punojnë kalimatesat e ofruar.
- Operatori ekonomik "LLAZO" shpk me NUIS K24218401K për arsyet e mëposhtme:
 - Furnizimi që ka paraqitur operatori ekonomik është pjesërisht i ngjashëm dhe vlera e tij është më e vogël se vlera e 40 % të vlerës së Fondit Limit objekt prokurimi sipas kriterit të kërkuar nga AK.
 - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt objekt prokurimi sipas kriterit të kërkuar nga AK.
 - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog/brosurë teknike nga prodhuesi e cila duhet të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar mbi vërtetësinë e përkthimit zyrtar për mallrat objekt prokurimi sipas specifikave të kërkuara nga AK.
- Operatori ekonomik "FMAC" shpk me NUIS M02303026K për arsyet e mëposhtme:
 - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt objekt prokurimi sipas kriterit të kërkuar nga AK.
 - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog/brosurë teknike nga prodhuesi e cila duhet të jetë e përkthyer në gjuhë shqipe dhe e noterizuar për vërtetësinë e përkthimit për mallrat objekt prokurimi sipas specifikave të kërkuara nga AK.
 - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur një vërtetim, kontratë pune apo çdo dokument mbi vërtetësinë e pasjes së të paktën një inxhinieri elektrik dhe një inxhinieri mekanik sipas kriterit të kërkuar nga AK.
 - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatë ISO 9001:2015 mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë" ose ekuivalente të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, sipas kriterit të kërkuar nga AK.
- Operatori ekonomik "START CO" shpk me NUIS L11614001S për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit ku vlera të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit limit sipas kriterit të kërkuar nga AK.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “VIBTIS” sh.p.k., adresa: Tiranë, Rruga "Dervish Hima", Arena Center, Seksioni B/C, Kati 5, me NIUS L02103503S, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 37,178,181 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferte e suksesshme.

* * *

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik të “Albpetrol” sha, rruga Fier – Patos km 7, Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj, dhe tenderi do të anulohet, siç parashikohet në nenet 83 dhe 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik operatori “NOVAMAT” shpk dhe është marrë Vendimi përfundimtar Nr. 166/2022 prot, datë 15.02.2022 i Komisionit të Prokurimit Publik.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Florjan MUÇAJ